



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 502/17 Prot.

Tiranë, më 13.02.2025

V E N D I M

Nr. 24 datë 13.02 2025

“PËR

NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 58 DATË 15.12.2020 ‘PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT MBI ORGANIZIMIN E CIKLIT TË
TRETË TË STUDIMEVE “DOKTORATË” NË “SHKENCA SPORTIVE” NË
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES” I NDRYSHUAR

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” gërma “c” e pikës 2 dhe gërma “c” dhe gërma “ç” e pikës 3, të nenit 3, nenit 38, nenit 46, në pikën 2 dhe 3 të nenit 58, pikës 3 të nenit 69, nenit 79, pikës 5 të nenit 95, pikës 2 dhe 3 të nenit 109, pikës 1 dhe 2 të nenit 113, pikës 14/a, b, pikës 15/ctë VKM nr.329 datë 12.04.2017 “Për trajtimin e veçantë të personelit akademik” në Udhëzimin nr. 7, datë 31.03.2021 të MAS për një ndryshim në Udhëzimin nr. 1 datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve”, të gërmës “f” të nenit 20 të Statutit të UST-së, të pikës 16 të nenit 7 të Rregullores së UST-së, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 13.02.2025

V E N D O S I:

1. Në fund të pikës 5 të Vendimit të Senatit nr.54, datë 28.06.2022, të shtohen fjalët “.....kur kandidati është drejtues i Grupit të një projekti kërkimor dhe kur tema e kërkimit të këtij të fundit nuk lidhet me temën e “Doktoratës” së kandidatit”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST-së.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr.Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1003/1 Prot.

Tiranë, më 28.06.2022

VENDIM

Nr. 54, datë 28.06.2022

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 77, DATË 29.04.2021 ‘PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT MBI RIORGANIZIMIN E CIKLIT TË
TRETË TË STUDIMEVE ‘DOKTORATË’ NË ‘AKTIVITETIN FIZIK DHE
SHËNDETI’ NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE
REKREACIONIT”**

Në zbatim ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, germa “c” e pikës 2 dhe germës “c” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 3, nenit 38, nenit 46, pikës 2 dhe 3 të nenit 58, pikës 3 të nenit 69, nenit 79, pikës 5 të nenit 95, pikës 2 dhe 3 të nenit 109, pikës 1 dhe 2 të nenit 113, pikës 14/a, b, pikës 15/c të VKM nr. 329, datë 12.04.2017 “Për trajtimin e veçantë të personelit akademik”, në Udhëzimin nr. 7, datë 31.03.2021 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, të germës “f” të nenit 20 të Statutit të UST-së, të pikës 16 të nenit 7 të Rregullores së UST-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.06.2022

VENDOSI :

1. Ndryshimin e pikës 2 të vendimit, si më poshtë:

Universiteti i Sporteve të Tiranës mbështet anëtarët e stafit akademik me 60% të koston e studimeve të doktoraturës si pjesë e kontributit për kërkimin shkencor dhe përparimin akademik”

2. Të propozojë për miratim Bordit të Administrimit tarifën e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Aktivitetin Fizik dhe Shëndeti sipas tabelës bashkëngjitur.
3. Të propozojë për miratim Bordit të Administrimit përjashtimin e kandidatëve të kësaj kategorie nga tarifat e aplikimit dhe rregjistrimit në ciklin e tretë Doktoratë në Aktivitetin Fizik dhe Shëndet.
4. Të propozojë për miratim Bordit të Administrimit që shuma prej 500.000 lekësh e mbetur nga tarifa e plotë, të përballohet nga të ardhurat e

institucionit dhe fondet e kërkimit shkencor të planifikuara nga granti për kategorinë e kandidatëve që vijnë nga rradhet e stafit akademik me kohë të plotë në UST.

5. Të propozojë për miratim Bordit të Administrimit që kandidatët të cilëve u është mbuluar pjesa e mbetur e tarifës prej 500.000 lekësh nga të ardhurat e institucionit, të përjashtohen nga përfitimi i granteve të tjera të ofruara nga të ardhurat e UST-së për periudhën e përfundimit të programit të ciklit të tretë.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AGRON KASA




TABELA E TARIFAVE TE SHKOLLIMIT PER CIKLIN E TRETE TE STUDIMEVE

Nr.	Fakulteti	Emërtimi i programit të studimit	Cikli i programit të studimit	Tarifa e shkollimit (për kandidatët nga stafi efektiv) në lekë	Tarifa e shkollimit për të tjerë (në lekë)
1	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti	Cikli i Tretë	300000	800000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Lënda: Relacion mbi propozimin për rishikimin e tarifës së shkollimit dhe pagesës së Komisionit të Doktoraturave

SENATIT AKADEMIK

Te nderuar anetar te Senatit akademik,

Në vijim të mbledhjes së zgjeruar të Rektoratit të Universitetit të Sporteve të Tiranës me përgjegjësit e departamenteve të të gjitha njësive kryesore, mori në shqyrtim propozimet e ardhura nga grupet e interesit rreth tarifës së shkollimit në ciklin e tretë të studimeve për stafin akademik me kohë të plotë.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH", germa "c" e pikës 2 dhe gërma "c" dhe "ç" të pikës 3 të nenit 3, pikës 2 dhe 3 të nenit 58, pikës 5 të nenit 95, pikës 2 dhe 3 të nenit 109, pikës 1 dhe 2 të nenit 113, vendosi t'i propozojë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit rishikimin e tarifës së shkollimit në ciklin e tretë të studimeve për Stafin Akademik me kohë të plotë në UST si dhe rishikimin e pagesës për anëtarët e Komisionit të Doktoraturës dhe koordinatorët e tyre sipas parimit të rëndësisë së procesit, punës materiale, përgjegjësisë për garantimin e cilësisë dhe paritetit me komisionet e tjera të krijuara nga Senati Akademik të cilat ushtrojnë funksione të ngjashme.

Pas një analize të hollësishme bazuar në Planin e Zhvillimit Strategjik të Institucionit për periudhën 2021-2026, ku në themel të tij qëndron kualifikimi dhe rritja e stafit akademik si një nga asetet kryesore të Institucionit, si dhe duke konsideruar që projektet e kërkimit shkencor të këtyre kandidateve do të mbeten pronë e UST-së për t'u shfrytëzuar si burim të ardhurash, propozohet që në parim tarifa e shkollimit për këtë kategori të ndahet midis Institucionit dhe kandidatit në raportet 60% Institucioni dhe 40% kandidati, e shprehur në vlerë nominale 500.000 lekë do të përballohen nga fondet e Institucionit dhe 300.000 lekë do të mbulohen nga kandidati.

REKTORATI